



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.2

14 janar

2007

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Ligj nr.9675 datë 13.1.2007	Për disa ndryshime në ligjin nr.8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”..... 39
Ligj nr.9676 datë 13.1. 2007	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar..... 40
Ligj nr.9677 datë 13.1.2007	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar..... 54
Dekret nr.5188 datë 13.1.2007	Për dhënien e pëlqimit për hyrjen në fuqi menjëherë të ligjit..... 56
Dekret nr.5189 datë 13.1.2007	Për dhënien e pëlqimit për hyrjen në fuqi menjëherë të ligjit..... 57
Dekret nr.5190 datë 13.1.2007	Për dhënien e pëlqimit për hyrjen në fuqi menjëherë të ligjit..... 57
Dekret nr.5194 datë 14.1.2007	Për shfuqizimin e dekretit nr.5131, datë 2.12.2006 “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore” dhe caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore..... 58

L I G J
Nr. 9675, datë 13.1.2007

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8417, DATË 21.10.1998
“KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Në mbështetje të neneve 83 pika 1 dhe 177 të Kushtetutës, me propozimin e më shumë se një të pestës së anëtarëve të Kuvendit,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Pika 1 e nenit 109 ndryshohet si më poshtë:

“1. Organet përfaqësuese të njësisive bazë të qeverisjes vendore janë këshillat, të cilat zgjidhen çdo katër vjet me zgjedhje të përgjithshme, të drejtpërdrejta dhe me votim të fshehtë.”.

Neni 2

Në nenin 154 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

Pika 1 riformulohet si më poshtë:

“1. Komisioni përbëhet nga 9 anëtarë, të cilët zgjidhen për një mandat 7-vjeçar. 4 anëtarë zgjidhen nga Kuvendi, 2 nga Presidenti i Republikës dhe 3 anëtarë të tjerë nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë.”.

Në pikën 2, togfjalëshi “çdo tre vjet” shfuqizohet.

Neni 3

Dispozitë kalimtare

1. Mandati katërvjeçar, i përcaktuar në nenin 1 të këtij ligji, zbatohet për herë të parë për këshillat dhe kryetarët e bashkive e të komunave që zgjidhen në zgjedhjet e para pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

2. Njëri nga mandatet e dy anëtarëve të KQZ-së, të zgjedhur në bazë të nenit 2 të këtij ligji, mbaron më 31 mars 2010, kurse tjetri më 31 mars 2013. Kuvendi përcakton me short se cili nga mandatet përfundon më 31 mars 2010. Procedurat e shortit përcaktohen nga Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin të Kuvendit të Shqipërisë.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.5191, datë 14.1.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

L I G J
Nr. 9676, datë 13.1. 2007

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.9087, DATË 19.6.2003 “KODI ZGJEDHOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 2 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 22 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Kuvendi i Shqipërisë zgjedh katër anëtarë të KQZ-së në bazë të propozimeve respektive të njëkohshme nga spektri i majtë dhe i djathtë i përbërjes politike të tij, përjashtuar partinë më të madhe të secilit spektër politik. Numri i kandidaturave që i paraqiten Kuvendit të Shqipërisë nuk është më i madh se dy për secilin vend vakant. Kandidaturat brenda grupimeve përzgjidhen me konsensus ose sipas numrit të votave mbështetëse të deputetëve që i përkasin të njëjtit spektër të propozuesit, përjashtuar partinë më të madhe të spektrit përkatës. Një deputet nuk duhet të mbështesë më shumë se një listë kandidaturash. Kandidaturat e propozuara i paraqiten Kuvendit nga Kryetari i tij dhe votohen njëkohësisht nga Kuvendi.”.

2. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Presidenti i Republikës emëron dy anëtarë të KQZ-së. Një anëtar propozohet nga partia e parë e spektrit të majtë dhe një anëtar nga partia e parë e spektrit të djathtë. Numri i kandidaturave të propozuara nuk është më i madh se dy për secilin vend vakant të KQZ-së.”.

Neni 2

Neni 26 ndryshohet si më poshtë:

“1. Përbërja e KQZ-së përtërihet në dy faza, sipas modaliteteve dhe procedurave të parashikuara në nenin 22 të këtij Kodi.

2. Në fazën e parë përtërihen 5 anëtarë të KQZ-së:

- a) dy anëtarë të zgjedhur nga Kuvendi, një për secilin spektër propozues;
- b) një anëtar i zgjedhur nga Presidenti i Republikës;
- c) dy anëtarë të zgjedhur nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

3. Në fazën e dytë përtërihen 4 anëtarë të KQZ-së:

- a) dy anëtarë të zgjedhur nga Kuvendi, një për secilin spektër propozues;
- b) një anëtar i zgjedhur nga Presidenti i Republikës;
- c) një anëtar i zgjedhur nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

4. Anëtarët e rinj të KQZ-së zgjidhen jo më vonë se 30 ditë para datës së mbarimit të mandatit të anëtarëve që largohen. Anëtarët e rinj fillojnë detyrën në datën e nesërme pas mbarimit të mandatit të anëtarëve që largohen.

5. Në rast të mbarimit të parakohshëm të mandatit të anëtarit të KQZ-së, organi që e ka zgjedhur anëtarin që largohet, emëron një anëtar zëvendësues brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të vakancës.

Anëtari zëvendësues fillon detyrën datën e nesërme pas zgjedhjes së tij dhe qëndron në detyrë deri në mbarimin e afatit të mandatit kushtetues dhe ligjor që gëzonte sipas aktit të zgjedhjes anëtari i larguar para kohe.

6. Në rast se mandati i një anëtari të KQZ-së përfundon para kohe gjatë periudhës së zgjedhjeve, ai zëvendësohet nga organi përkatës sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 48 orë nga krijimi i vakancës.”.

Neni 3

Në nenin 27, numri 7 zëvendësohet me numrin 9 dhe numri 5 zëvendësohet me numrin 6.

Neni 4

Në nenin 28 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Kryetari i ushtron kompetencat në bazë të shkronjës “a” të pikës 1 të këtij neni së bashku me Zëvendëskryetarin. Të gjitha aktet e nxjerra në bazë të shkronjës “b” të pikës 1 të këtij neni nënshkruhen edhe nga Zëvendëskryetari.”.

Neni 5

Në nenin 30 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Mbledhjet e KQZ-së thirren nga Kryetari dhe Zëvendëskryetari ose të paktën nga dy anëtarë të KQZ-së. Në çdo rast, thirrja duhet të përmbajë rendin e ditës të mbledhjes.”.

2. Pika 5 ndryshohet si më poshtë:

“5. Mbledhjet e KQZ-së janë të vlefshme kur marrin pjesë jo më pak se 5 anëtarë të saj, me përjashtim të rasteve kur kërkohet shumicë e cilësuar për marrjen e vendimit, sipas pikës 6 të këtij neni.”.

3. Pika 6 ndryshohet si më poshtë:

“6. Miratohen kur votojnë pro jo më pak se 6 anëtarë të KQZ-së, vendimet lidhur me:

- a) shpalljen e rezultatit të votimit për listat shumëmemërore për Kuvendin;
 - b) vendimet lidhur me ankimet kundër vendimeve të KZZ-ve ose KZQV-ve për rezultatin e zgjedhjeve;
 - c) vendimet për kërkesat për deklarimin e pavlefshëm të zgjedhjeve.
- Vendimet e tjera miratohen me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të KQZ-së.”.

Neni 6

Në nenin 34 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. KZZ-ja përbëhet nga 13 anëtarë dhe sekretari, të cilët emërohen nga KQZ-ja, sipas procedurës së mëposhtme:

a) një anëtar propozohet nga partia kryesore e shumicës parlamentare, një anëtar propozohet nga partia kryesore e opozitës parlamentare, pesë anëtarë propozohen nga partia e dytë, e tretë, e katërt, e pestë dhe e gjashtë e shumicës parlamentare dhe pesë anëtarë propozohen nga partia e dytë, e tretë, e katërt, e pestë dhe e gjashtë e opozitës parlamentare. Në rast se nuk arrihet baraspeshimi politik, sipas kësaj shkronje, grupi përkatës kompensohet me kandidaturat e partisë kryesore deri në baraspeshimin politik shumicë-opozitë;

b) anëtari i 13-të propozohet në gjysmën e KZZ-ve nga partia e parë e shumicës parlamentare, kurse gjysma tjetër nga partia e parë e opozitës parlamentare, sipas kriterëve objektive të bazuara në:

- i) përzgjedhjen rastësore;
- ii) shpërndarjen e barabartë në territorin zgjedhor;

c) sekretari i KZZ-së duhet të jetë jurist dhe propozohet nga partia, e cila propozon zëvendëskryetarin e kësaj KZZ-je.”.

2. Në pikën 2 fjalët “anëtari i shtatë” zëvendësohen me fjalët “anëtari i trembëdhjetë”.

Neni 7

Në nenin 40 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. KZQV-ja përbëhet nga 13 anëtarë dhe sekretari, të cilët emërohet nga KQZ-ja, sipas procedurës së mëposhtme:

a) një anëtar propozohet nga partia kryesore e shumicës parlamentare, një anëtar propozohet nga partia kryesore e opozitës parlamentare, pesë anëtarë propozohen nga partia e dytë, e tretë, e katërt, e pestë dhe e gjashtë e shumicës parlamentare dhe pesë anëtarë propozohen nga partia e dytë, e tretë, e katërt, e pestë dhe e gjashtë e opozitës parlamentare. Në rast se nuk arrihet baraspeshimi politik, sipas kësaj shkronje, grupi përkatës kompensohet me kandidaturat e partisë kryesore deri në baraspeshimin politik shumicë-opozitë;

b) anëtari i 13-të propozohet në gjysmën e KZQV-ve nga partia e parë e shumicës parlamentare, kurse gjysma tjetër nga partia e parë e opozitës parlamentare, sipas kritereve objektive të bazuara në:

i) përzgjedhjen rastësore;

ii) shpërndarjen e barabartë në territorin zgjedhor;

c) sekretari i KZQV-së, si rregull duhet të jetë me arsim të lartë dhe propozohet nga partia, e cila propozon zëvendëskryetarin e kësaj KZQV-je.”.

2. Në pikën 2 fjalët “anëtari i shtatë” zëvendësohen me fjalët “anëtari i trembëdhjetë”.

3. Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. KZQV-të ngrihen në përputhje me rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve të fundit për Kuvendin jo më herët se 8 muaj dhe jo më vonë se 6 muaj para përfundimit të mandatit të organeve të qeverisjes vendore.”.

4. Pas pikës 6 shtohet pika 6/1 me këtë përmbajtje:

“6.1. Për Tiranën ngrihen, sipas këtij neni, KZQV-të e njëjste bashkiake dhe KZQV-ja për Bashkinë e Tiranës.”.

Neni 8

Në nenin 40/2, shkronja “b” të fillojë me fjalët “si rregull”.

Neni 9

Neni 50 ndryshohet si më poshtë si më poshtë:

“1. Lista e zgjedhësve hartohet për çdo zonë qendre votimi. Lista e zgjedhësve përmban të gjithë zgjedhësit që kanë vendbanimin në zonën e qendrës së votimit të njësisë së qeverisjes vendore, mbështetur në të dhënat e regjistrit themeltar me vendbanim të shtetasve dhe zgjedhësit, sipas neneve 63, 64 dhe 64/1 të këtij Kodi.

2. Zgjedhësi regjistrohet vetëm në një listë zgjedhësish. Përfshirja në listën e zgjedhësve si zgjedhës, sipas neneve 63, 64 dhe 64/1 të këtij Kodi, sjell si pasojë heqjen e zgjedhësit nga lista e zgjedhësve që hartohet në bazë të regjistrit themeltar me vendbanim të shtetasve.”.

Neni 10

Në nenin 53 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 2 shfuqizohet.

2. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Ministri që mbulon pushtetin vendor nxjerr akte nënligjore lidhur me administrimin dhe përditësimin e përbërësve zgjedhorë në regjistrin themeltar të shtetasve me vendbanim.”.

Neni 11

Në nenin 55, fjalia e fundit e pikës 4 shfuqizohet.

Neni 12

Në nenin 57 shkronja “ç” e pikës 1 ndryshohet si më poshtë:
“ç) ka transferuar gjendjen civile.”.

Neni 13

Shkronja “a” e nenit 58/1 ndryshohet si më poshtë:

“a) në bazë të verifikimit të kryer nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile rezulton se të njëjtët zgjedhës janë përfshirë si në listën e zgjedhësve të vendbanimit të tyre, ashtu dhe në listën e zgjedhësve të vendbanimit të origjinës. Në këtë rast, jo më vonë se 25 ditë para datës së zgjedhjeve, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile i kërkon kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore të vendbanimit të origjinës ta heqë atë nga lista e zgjedhësve;”.

Neni 14

Neni 64/2 shfuqizohet.

Neni 15

Neni 87 ndryshohet si më poshtë:

“1. Për caktimin e kandidatëve për anëtarë të këshillave të bashkive dhe të komunave, partitë politike të regjistruara paraqesin në KZQV një listë kandidatësh, numri i të cilëve nuk duhet të jetë më i vogël se gjysma e numrit të anëtarëve të këshillit të njësisë vendore përkatëse.

2. Lista e kandidatëve, sipas formularit të përgatitur nga KQZ-ja, i dorëzohet KZQV-së brenda afatit për paraqitjen e kandidaturave për kryetar bashkie dhe komune.

3. Çdo kandidat në listë deklaron se pranon të kandidojë për subjektin zgjedhor përkatës.

4. Lista nënshkruhet nga kryetari i partisë ose personi i autorizuar prej tij për të mbështetur kandidatët.

5. Renditja e kandidatëve në listë caktohet nga subjekti zgjedhor që e paraqet atë.

6. Kur ka marrëveshje të subjektit zgjedhor për renditjen përfundimtare të kandidatëve të listës, ajo depozitohet bashkë me listën. Marrëveshja zbatohet drejtpërdrejt nga KZQV-ja kur:

a) përmban formulën e caktimit të renditjes përfundimtare të kandidatëve të listës shumemërore;

b) marrëveshja është e nënshkruar nga kryetari i partisë.

7. Në rast vdekjeje të një kandidati të listës, vazhdohet me kandidatin pasues në renditje.”.

Neni 16

Neni 88 shfuqizohet.

Neni 17

Neni 95/2 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 95/2

1. Për numërimin e votave në rang njësie zgjedhore, me vendim të KZZ-së ose KZQV-së, 2 ditë para ditës së votimit, caktohen grupe numërimi. Në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë ngrihen deri në 10 grupe numërimi dhe në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore ngrihen deri në 15 grupe numërimi në bashkitë e mëdha dhe deri në 5 grupe numërimi në bashkitë e vogla dhe komunat. Përbërja e grupeve të numërimit pasqyron përbërjen e KZZ-së ose KZQV-së.

2. Në rast se ndonjë nga subjektet zgjedhore nuk paraqet propozime brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, KZZ-ja ose KZQV-ja cakton me short anëtarët zëvendësues midis anëtarëve të KQV-ve që i përkasin këtij subjekti zgjedhor në rang njësie zgjedhore.

3. Një grup numërimi numëron jo më pak se 5 qendra votimi dhe jo më shumë se 15 qendra votimi. Nëse është e nevojshme, për organizimin e numërimit organizohen turne për secilin grup numërimi. Ngritja e grupit të ri të numërimit bëhet në përputhje me pikën 1 të këtij neni.

4. KQZ-ja përcakton me akt normativ kriteret për numrin e grupeve të numërimit për çdo vend të numërimit të votave, mënyrën e organizimit të punës, ndarjen e detyrave midis anëtarëve të grupit të numërimit dhe rregullat për radhën e veprimeve. Për lehtësimin e punës dhe për rritjen e transparencës, KQZ-ja vendos për përdorimin e kamerave regjistruuese dhe të monitorëve (ekraneve) për shfaqjen e fletëve të votimit përpara vlerësimit të tyre.”.

Neni 18

Në nenin 97 pika 1 shkronja “e” fjalia e parë ndryshohet si më poshtë:

“e) vulos kutitë e votimit me kodet e sigurisë dhe numrat e vulave të sigurisë i shënon në Procesverbalin e Vulosjes së kutive të votimit dhe në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së, të cilat nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e KQV-së;”.

Neni 19

Në nenin 99, pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. Në rast se në qendrën e votimit vendosen më shumë se një kuti votimi, KQZ-ja përcakton elementet dalluese të kutive të votimit.”.

Neni 20

Neni 100 riformulohet si më poshtë:

“Neni 100

Paraqitja e zgjedhësit në qendrën e votimit

1. Pas hyrjes së zgjedhësit në qendrën e votimit:

a) zgjedhësi thotë emrin dhe paraqet para KQV-së një nga dokumentet zyrtare të identitetit si më poshtë:

i) letërnjoftim;

ii) pasaportë;

iii) certifikatë lindjeje me fotografi, e lëshuar nga zyra përkatëse e gjendjes civile e njësisë së qeverisjes vendore, e cila ka hartuar listën e zgjedhësve në të cilën figuron zgjedhësi;

b) një prej anëtarëve, i caktuar me vendim të KQV-së, kontrollon zgjedhësit në të dy duart, në çastin e paraqitjes para KQV-së, nëse është timbruar ose jo me lëndën e posaçme. Në rast se zgjedhësi është timbruar, anëtari i KQV-së ia bën të ditur menjëherë këtë fakt anëtarëve të tjerë të KQV-së, të cilët e verifikojnë menjëherë. Emri dhe mbiemri i këtij zgjedhësi shënohen në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së dhe ai nuk lejohet të votojë;

c) kryetari, pasi verifikon se të dhënat e identitetit të zgjedhësit përputhen me të dhënat në listën e zgjedhësve, shënon në listën e zgjedhësve llojin dhe numrin e serisë të dokumentit të identitetit dhe i heq vizë emrit të zgjedhësit në këtë listë;

ç) zgjedhësi nënshkruan në listën e zgjedhësve anash emrit të tij;

d) fleta e votimit vuloset në pjesën e pasme të saj me vulën e KQV-së dhe vulën e Kryetarit të KQV-së;

dh) zgjedhësi timbroset në dorën e majtë nga një anëtar i caktuar me vendim të KQV-së me një lëndë të posaçme, të dukshme me shikim të lirë dhe që nuk hiqet për jo më pak se 24 orë, me qëllim shmangien e votimit më shumë se një herë dhe më pas i jepet fleta e votimit.

Në rast se zgjedhësi nuk pranon të timbroset me lëndën e posaçme, ai nuk lejohet të votojë dhe mbahet shënim në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së identiteti i tij.

2. Kur përpara KQV-së paraqitet një zgjedhës, i cili nuk është regjistruar në listën përfundimtare të zgjedhësve, por është i pajisur me vendim gjykate i cili i jep të drejtë të votojë në atë qendër votimi, sipas nenit 60 të këtij Kodi, KQV-ja shënon emrin e zgjedhësit në një regjistër të veçantë dhe bashkëlidh vendimin e gjykatës si dhe një certifikatë personale me fotografi të zgjedhësit.”.

Neni 21

Në nenin 109, pas pikës 6 shtohet pika 7 me këtë përmbajtje:

“7. Për Bashkinë e Tiranës materialet e votimit për Kryetar Bashkie të Tiranës dhe për Këshillin Bashkiak të Tiranës, lista e zgjedhësve, vula e KQV-së, vula e Kryetarit të KQV-së, vula me kodet e sigurisë të papërdorura apo të dëmtuara, si dhe Libri i Protokollit të Mbledhjeve futen në një kuti të veçantë të materialeve zgjedhore me emërtimin e vendosur dukshëm në pjesën e jashtme “BASHKIA E TIRANËS”. Materialet e tjera zgjedhore vendosen në një kuti të dytë me emërtimin e vendosur dukshëm në pjesën e jashtme të kutisë “NJËSIA BASHKIAKE NR.””.

Neni 22

Në nenin 109/1, në fund të pikës 1 shtohet fjalia si më poshtë:

“Për Bashkinë e Tiranës, kutitë e votimit dhe kutitë me materialet e votimit për Kryetarin e Bashkisë dhe Këshillin Bashkiak dorëzohen në KZQV-në e njësisë bashkiake përkatëse.”.

Neni 23

Në nenin 109/3 bëhen këto ndryshime:

1. Në fund të pikës 1 shtohet ky paragraf:

“Për Bashkinë e Tiranës, KZQV-ja e njësisë bashkiake fillon numërimin sipas këtij rendi:

- a) kutitë e votimit për Kryetar të Bashkisë së Tiranës dhe të Këshillit Bashkiak të Tiranës;
- b) kutitë e votimit për Kryetarin e Njësisë Bashkiake dhe të Këshillit të Njësisë Bashkiake.”.

2. Në pikën 2 fjalia e parë riformulohet si më poshtë:

“2. Sekretarët e grupeve të numërimit, me radhë, sipas numrit rendor rritës të qendrave të votimit, marrin nga stiva e kutive të votimit kutitë e votimit me fletët e votimit dhe kutinë respektive me materialet e votimit të vetëm një qendre votimi dhe i vendosin pranë tryezës së Grupit të Numërimit përkatës.”.

Neni 24

Neni 109/7 ndryshohet si më poshtë:

1. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Për nxjerrjen e rezultatit, KZZ-ja ose KZQV-ja plotëson Tabelën Përmbledhëse të Rezultateve të Zgjedhjeve, në të cilën pasqyrohen shumat e të dhënave respektive për çdo QV mbi bazën e origjinaleve të Tabelave të Rezultateve për çdo QV të plotësuar nga grupet e numërimit.”.

2. Pas pikës 6 shtohet pika 7 me këtë përmbajtje:

“7. Në Bashkinë e Tiranës, KZQV-të e njësisë bashkiake plotësojnë dhe miratojnë me vendim edhe Tabelën Përmbledhëse që i korrespondon kutive të votimit për Kryetarin dhe Këshillin e Bashkisë.

KZQV-ja pranë Bashkisë së Tiranës administron Tabelat Përmbledhëse të ardhura nga KZQV-të e njësisë bashkiake, ajo plotëson dhe miraton me vendim Tabelën Përmbledhëse përfundimtare të Bashkisë së Tiranës.

Rezultati i zgjedhjeve, si rregull, nxirret jo më vonë se ora 20⁰⁰ e ditës së nesërme të votimit.”.

3. Pas pikës 7 shtohet pika 8 me këtë përmbajtje:

“8. Në rast se KZQV-ja e njësisë bashkiake të Tiranës nuk arrin të marrë vendim brenda afatit përkatës, çështja i dërgohet brenda 24 orëve për shqyrtim KQZ-së nga kryetari i KZQV-së së njësisë bashkiake përkatëse ose të paktën nga dy anëtarë, ose mund të ankimohet në KQZ nga subjekti zgjedhor i interesuar. Vendimi i KQZ-së zbatohet nga KQZV-ja përkatëse. Në rast se çështja është dërguar nga kryetari i KZQV-së së njësisë bashkiake ose të paktën nga dy anëtarë të saj, KQZ-ja merr vendim në përputhje me nenin 30 pikat 5 dhe 6 të këtij Kodi, ndërsa në rast ankimi nga subjekti i interesuar, KQZ-ja vendos sipas dispozitave të Kreut I të Pjesës së Dymbëdhjetë të këtij Kodi.”.

Neni 25

Në nenin 117 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Pikat 1 dhe 2 riformulohen si më poshtë:

“1. KQZ-ja, kryesisht ose me kërkesë të subjekteve zgjedhore, shpall zgjedhjet të pavlefshme, në rast se:

a) kanë ndodhur shkelje të ligjit;

a/1) konstaton se numri zgjedhësve që kanë votuar me certifikatë lindjeje me fotografi të falsifikuar është më i madh se diferenca midis dy kandidatëve të renditur të parët mbi bazën e rezultatit të shpallur nga KZZ-ja ose KZQV-ja;

b) kanë ndodhur fatkeqësi natyrore në përmasa të tilla, që kanë penguar pjesëmarrjen e zgjedhësve në votim; ose

c) votimi nuk ka filluar ose është pezulluar për më shumë se gjashtë orë; dhe

për cilindo nga këto shkaqe është cenuar procesi zgjedhor në një masë të tillë që mund të ketë ndikuar në ndarjen e mandateve në njësitë zgjedhore ose në shkallë vendi apo në miratimin ose refuzimin e referendumit.

2. Subjektet zgjedhore, brenda 3 ditëve nga shpallja e rezultatit nga KZZ-ja ose KZQV-ja, kanë të drejtë të kërkojnë në KQZ shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve në qendra të caktuara votimi, në njësi të veçanta zgjedhore ose në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.”.

3. Në pikën 4, fjalia e parë dhe fjalia e fundit shfuqizohen.

4. Në fillim të pikës 5 shtohet fjalia si më poshtë:

“KQZ-ja urdhëron përsëritjen e zgjedhjeve në njësinë zgjedhore, në një ose më shumë qendra votimi të së cilës zgjedhjet janë deklaruar të pavlefshme ose, sipas rastit, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, kur për cilindo nga shkaqet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni është cenuar procesi zgjedhor në një masë të tillë që mund të ketë ndikuar në ndarjen e mandateve në njësitë zgjedhore ose në shkallë vendi apo në miratimin ose refuzimin e referendumit.”.

5. Fjalët “Pavarësisht nga pika 4 e këtij neni” shfuqizohen.

Neni 26

Në nenin 146 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1 fjalët “dy ditëve” zëvendësohen me fjalët “tri ditëve”.

2. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Kërkesat, sipas nenit 117 të këtij Kodi, për shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve mund të shqyrtohen njëherësh me ankimet e paraqitura sipas pikës 1 të këtij neni. Paraqitja e kërkesës për pavlefshmëri shqyrtohet njëherësh me çdo ankim tjetër të paraqitur nga subjekti.”.

Neni 27

Në nenin 147 bëhen këto ndryshime:

1. Në fund të pikës 1 shtohet fjalia e mëposhtme:

“Kërkesa për shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve përmban, për aq sa është e mundur, elementet e parashikuara në këtë pikë.” .

2. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Subjekti zgjedhor ankues duhet të depozitohet së bashku me ankimin edhe vendimin e plotë, ndaj të cilit ushtron ankimin, me përjashtim të rastit kur KZZ-ja ose KZQV-ja nuk merr vendim.”.

Neni 28

Pika 1 e nenit 148 ndryshohet si më poshtë:

“1. Kërkesat ankimore dhe kërkesat për shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve depozitohen në selinë e KQZ-së. KQZ-ja regjistron kërkesat në një regjistër të posaçëm, i cili shërben vetëm për regjistrimin e kërkesave ankimore dhe të kërkesave për shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve. Regjistri i ankimeve është vetëm për zgjedhjet e radhës. Hapja e regjistrit të kërkesave ankimore për zgjedhjet e radhës bëhet jo më vonë se 24 orë nga shpallja e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve të radhës. Në këtë regjistër shënohen edhe kërkesat ankimore për zgjedhjet e pjeshme që zhvillohen midis dy zgjedhjeve të përgjithshme.”.

Neni 29

Në nenin 152 pika 2 fjalia e fundit shfuqizohet.

Neni 30

Neni 153 ndryshohet si më poshtë:

“1. Në shqyrtimin e ankimit nga KQZ-ja kanë të drejtë të marrin pjesë, duke paraqitur kërkesa, duke ngritur pretendime dhe duke bërë prapësime të pretendimeve të ngritura, si dhe duke paraqitur prova vetëm:

a) ankuesi;

b) pala e interesuar. Palë e interesuar është çdo subjekt zgjedhor, të drejtat dhe interesat e ligjshëm të të cilit, qofshin këta individualë ose të përbashkët, preken ose kanë të ngjarë të preken nga vendimi që mund të jepet në përfundim të procedurës administrative.

2. Pala e interesuar depoziton kërkesën e saj për të marrë pjesë në shqyrtimin e një ankimi, jo më vonë se ora e caktuar për zhvillimin e seancës. Depozitimi jashtë këtij afati passjell mospranimin e kërkesës.

3. Pranimi i palës së interesuar në procedurën administrative bëhet me vendim të KQZ-së në fillim të seancës përkatëse dhe pas verifikimit të pjesëmarrjes së palëve të tjera.

4. Palët kanë të drejtë të përfaqësohen gjatë procedurës administrative nga përfaqësues të autorizuar prej tyre ose me deklaram në seancë. Subjektet zgjedhore të përfaqësuara në KQZ, si rregull, përfaqësohen nga përfaqësuesit e akredituar të tyre në KQZ. Kandidatët e pavarur përfaqësohen nga persona të pajisur me prokurë.”.

Neni 31

Në nenin 154 pika 5 ndryshohet si më poshtë:

“5. Gjatë shqyrtimit të kërkesës ankimore mbahet procesverbal nga një punonjës i caktuar nga KQZ-ja dhe, për sa është e mundur, seanca plenare regjistrohet me zë dhe/ose figurë. Në procesverbal shënohen në mënyrë të përmbledhur shpjegimet e palëve dhe pasqyrohen në mënyrë të plotë provat që merren, si dhe urdhrat dhe vendimet e ndërmjetme të KQZ-së.”.

Neni 32

Në nenin 156 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

“5. Pavarësisht nga përcaktimet e bëra në këtë nen, kur KQZ-ja çmon se një fakt, rrethanë ose ngjarje ka ndodhur, ajo merret si provë, pavarësisht nëse nuk është pasqyruar në ndonjë dokument zgjedhor.”.

Neni 33

Neni 158 riformulohet si më poshtë:

“1. Për nevojat e hetimit administrativ, KQZ-ja, me kërkesë të palëve ose kryesisht, ka të drejtë të këqyrë dokumentacionin dhe materialin zgjedhor që ndodhet në kutinë e materialeve zgjedhore dhe/ose kutitë e votimit, si dhe çdo dokumentacion apo material tjetër zgjedhor. Kur materiali zgjedhor ndodhet brenda kutive me vula sigurie, hapja dhe rimbyllja e tyre bëhen sipas procedurave që parashikon ky Kod për hapjen dhe mbylljen e kutive, duke treguar dhe shënuar kodet me të cilat kutitë përkatëse janë mbyllur nga KZZ-ja ose KZQV-ja, si dhe numrat me të cilat ato mbyllën rishtazi.

2. Këqyrja e materialit zgjedhor bëhet në prani të palëve dhe publikut. Pas këqyrjes së materialit dhe/ose dokumentacionit zgjedhor palët kanë të drejtë të paraqesin vlerësimet dhe pretendimet e tyre. Provat e gjetura paraqiten në procesverbalin e mbledhjes së KQZ-së.

3. KQZ-ja, me kërkesë të palëve ose kryesisht, kur çmon se për dhënien e vendimit është i nevojshëm rinumërimi dhe/ose rivlerësimi i votave të caktuara, kryen në praninë e palëve rinumërimin dhe/ose rivlerësimin e votave dhe pasqyron përfundimin në procesverbalin e mbledhjes së KQZ-së dhe vendimin përkatës të saj.

4. Në rastin e kutive të votimit të konstatuara si KUTI TË PARREGULLTA nga KZZ-ja ose KZQV-ja dhe për të cilat KQZ-ja, kryesisht ose me kërkesë të subjektit zgjedhor shprehet me vendim se janë kuti të rregullta, KQZ-ja kryen numërimin fillestar të votave në këto kuti.

5. Vendimet e KQZ-së, sipas pikave 3 dhe 4 të këtij neni, mund të ankimohen së bashku me vendimin e KQZ-së, sipas nenit 161/3 të këtij Kodi.”.

Neni 34

Neni 161/1 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 161/1

Heqja dorë nga ankimi

1. Ankuesi ka të drejtë të heqë dorë nga ankimi në çdo fazë të shqyrtimit të tij. Në këtë rast KQZ-ja vendos pushimin e çështjes. Pas kësaj ankuesi nuk mund ta riparaqesë përsëri ankimin, për të cilin është vendosur pushimi i çështjes.

2. KQZ-ja, në përjashtim nga rasti i pikës 1 të këtij neni, kur çmon se ka një interes publik për vijimin e shqyrtimit të ankimit, mund të vijojë shqyrtimin e tij edhe pse ankuesi ka hequr dorë nga ankimi.”.

Neni 35

Neni 161/2 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 161/2

Lloji i vendimeve që merr KQZ-ja pas shqyrtimit të ankimeve dhe afatet

1. Në përfundim të shqyrtimit të ankimit KQZ-ja vendos sipas rastit:

- a) pushimin e shqyrtimit;
- b) lënien në fuqi të vendimit të KZZ-së ose KZQV-së;
- c) ndryshimin e vendimit të KZZ-së ose KZQV-së;
- ç) shpall zgjedhjet të pavlefshme në një ose disa QV të njësisë zgjedhore ose në të gjithë njësinë zgjedhore.

2. KQZ-ja merr vendim sipas njërit nga rastet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, pavarësisht nga ajo çfarë ankuesi ka kërkuar në ankimin e tij.

3. KQZ-ja merr vendim përfundimtar, në lidhje me ankimin ndaj vendimit të KZZ-së ose KZQV-së për shpalljen e rezultatit, jo më vonë se 10 ditë nga data kur është regjistruar ankimi përkatës. Në çdo rast tjetër, KQZ-ja merr vendim jo më vonë se 2 ditë nga paraqitja e ankimit.

4. Në rastin e bashkimit të kërkesave ankimore, afatet llogariten nga data e regjistrimit të kërkesës së fundit ankimore.”.

Neni 36

Në të gjithë nenin 161/3 fjalët “5 vota” ndryshohen me fjalët “6 vota”.

Neni 37

Në nenin 162 pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Subjektet zgjedhore kanë të drejtë të bëjnë ankim në Kolegjin Zgjedhor për mosmarrje të vendimit brenda afatit ligjor nga KQZ-ja. Në këtë rast Kolegji Zgjedhor nuk e gjykon çështjen në themel dhe, kur pranon kërkesën, vendos detyrimin e KQZ-së për të marrë vendim. Përjashtim nga ky rregull bëjnë vendimet e KQZ-së për rrëzimin e kërkesës të marra në përputhje me nenin 161/3.”.

Neni 38

Pas nenit 181 shtohet neni 181/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 181/1

Dispozitë afatesh të posaçme për zgjedhjet vendore 2007

1. Për zgjedhjet vendore të vitit 2007 Presidenti i Republikës, pavarësisht nga përcaktimet e bëra në nenin 7 pika 8 të këtij Kodi, në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, ricakton datën e zhvillimit të zgjedhjeve, jo më vonë se data 20 shkurt 2007.

2. Pavarësisht nga përcaktimet e bëra në nenin 40 pika 4 të këtij Kodi, partitë politike propozojnë dhe KQZ-ja miraton përbërjen e KZQV-ve brenda 7 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Pavarësisht nga neni 15, subjektet zgjedhore regjistrohen në KQZ jo më vonë se 7 ditë nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

3. Dokumentacioni për paraqitjen e kandidatëve për kryetar bashkie ose komune apo për këshillin e bashkisë ose komunës, dorëzohet në KZQV jo më vonë se 10 ditë nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji. KZQV-ja verifikon saktësinë e dokumentacionit të paraqitur jo më vonë se 2 ditë nga mbarimi i afatit, sipas fjalisë së parë të kësaj pike.”.

Neni 39

Pas nenit 181/1 shtohet neni 181/2 me këtë përmbajtje:

“Neni 181/2

Dispozitë kalimtare

Për zgjedhjet vendore 2007 zbatohen edhe këto rregulla të posaçme:

1. Zgjedhësi, i cili voton me certifikatë lindjeje me fotografi të lëshuar nga çasti i krijimit të Regjistrimit të Posaçëm të Gjendjes Civile deri një ditë përpara datës së zgjedhjeve, lejohet të votojë vetëm nëse certifikata është regjistruar në një Regjistër të Posaçëm, i cili mbahet nga nëpunësi përkatës i gjendjes civile. Në këtë regjistër shënohet identiteti i zgjedhësit, data e lëshimit të certifikatës, si dhe numri serial i certifikatës.

2. Jo më vonë se 24 orë përpara datës së zgjedhjeve zyra e gjendjes civile i dërgon KZQV-së së njësisë vendore përkatëse kopje të Regjistrit të Posaçëm, të vulosur me vulë dhe të nënshkruar nga drejtuesi i zyrës së gjendjes civile për certifikatat e lëshuara në periudhën e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni. Nga një kopje të Regjistrit të Posaçëm të vërtetuar ligjërisht i dorëzohet respektivisht partisë me numër më të madh vendesh në Kuvend pjesëmarrëse në qeveri dhe partisë me numër më të madh vendesh jopjesëmarrëse në qeveri.

3. Jo më vonë se 12 orë përpara fillimit të votimit KZQV-ja i shpërndan çdo KQV-je, të njësisë përkatëse zgjedhore kopje të vërtetuara të Regjistrit të Posaçëm të certifikatave të lëshuara, të dërguara nga zyra e gjendjes civile.

4. Zyra e gjendjes civile shënon në një procesverbal, të mbajtur në mënyrë të njëanshme prej saj, numrat serialë të certifikatave të lindjes, të cilat ajo mund t'i lëshojë në periudhën një ditë përpara ditës së votimit deri në mbyllje të tij. Ky procesverbal mbahet veçmas për çdo qendër votimi. Veç sa më sipër, zyra e gjendjes civile shënon në Regjistrin e Posaçëm përkatës të lëshimit të certifikatave të lindjes, të gjitha certifikatat e mundshme që ajo mundet të lëshojë, për çfarëdoqëllimi, edhe në periudhën një ditë përpara datës së zgjedhjeve deri në ditën e votimit.

5. Sasia e certifikatave, të cilat do të shënohen sipas pikës 4 të këtij neni, nuk duhet të jetë më e madhe se numri i zgjedhësve në listën përfundimtare të zgjedhësve të asaj njësie vendore dhe për çdo qendër votimi.

6. Kopje e vërtetuar sipas pikës 2 të këtij neni e procesverbalit i dorëzohet KZQV-së së njësisë vendore përkatëse jo më vonë se një ditë përpara datës së votimit. Jo më vonë se 12 orë përpara fillimit të votimit, KZQV-ja i shpërndan çdo KQV-je të njësisë përkatëse zgjedhore një kopje të vërtetuar të këtij procesverbali, sipas qendrës përkatëse të votimit.

7. Zgjedhësi që paraqitet për të votuar me certifikatë lindjeje me fotografi, të lëshuar në periudhën një ditë përpara datës së zgjedhjeve deri në mbyllje të votimit, lejohet të votojë vetëm në rast se krahas të tjerave numri serial i certifikatës së lindjes që ai paraqet përputhet me një nga numrat serialë të certifikatave të regjistruara në procesverbalin e mbajtur sipas pikës 4 të këtij neni për atë qendër votimi.

8. Jo më vonë se 5 ditë nga hyrja në fuqi e këtij ligji, Ministria e Brendshme i dërgon çdo KZQV-je një procesverbal, në të cilin janë shënuar sasia dhe numri serial i certifikatave, të cilat i janë shpërndarë respektivisht çdo zyre të gjendjes civile të çdo njësie vendore. Ekzemplarë origjinalë të këtij procesverbali, për çdo njësi vendore, u shpërndahen, zyrtarisht, brenda afatit të mësipërm kryetarëve të grupeve parlamentare. Jo më vonë se 3 ditë përpara datës së zgjedhjeve, KZQV-ja i shpërndan kopje të vërtetuar të këtij procesverbali çdo KQV-je të njësisë përkatëse zgjedhore.

9. Në përjashtim nga rregulli i parashikuar në pikën 1 të këtij neni zgjedhësi, i cili paraqitet për të votuar me certifikatë lindjeje, me fotografi, të lëshuar në periudhën përpara krijimit të Regjistrit të Posaçëm të Gjendjes Civile, lejohet të votojë nëse numri serial i certifikatës së lindjes, me të cilën ai paraqitet, përputhet me një nga numrat serialë të certifikatave të lindjes të pasqyruara në procesverbalin e mbajtur sipas pikës 8 të këtij neni dhe nëse njëkohësisht paraqet detyrimisht dy nga dokumentet origjinale të mëposhtme:

a) pasaportë me fotografi të padëmtuar, por që i ka skaduar afati ligjor i përdorimit;
b) leje e dixhitalizuar për drejtim automjeti;
c) diplomë origjinale të shkollës së lartë, me fotografi të padëmtuar;
ç) diplomë origjinale të shkollës së mesme, me fotografi të padëmtuar;
d) dokument të lëshuar nga një zyrë noteriale në bashkinë përkatëse mbi pasuri të patundshme;

dh) librezë notash e studentëve aktualë;
e) licencë të ushtrimit të profesionit privat, me fotografi, e lëshuar nga viti 2000 e në vazhdim, nga organi tatimor i njësisë vendore ku zgjedhësi ka emrin në listën përfundimtare të zgjedhësve;

ë) certifikatë tatimore, e lëshuar nga viti 2000 e në vazhdim, e pajisur me fotografi, e lëshuar nga organi tatimor i njësisë vendore ku zgjedhësi ka emrin në listën përfundimtare të zgjedhësve.

Partitë politike si dhe subjektet zgjedhore përkatëse, kur e çmojnë, kanë të drejtë që të disponojnë për verifikim, paraprakisht, listat e regjistrimit të zyrave që administrojnë dhe lëshojnë dokumentet e mësipërme. Pas verifikimit këto lista u bëhen prezent KQZV-ve dhe KQV-ve.

Zgjedhësi dorëzon në KQV certifikatën e përdorur dhe fotokopje të dokumenteve origjinale mbështetëse. Në certifikatën dhe fotokopjet e dorëzuara, zgjedhësi shënon emrin e mbiemrin dhe nënshkruan.

10. Kur zgjedhësi nuk paraqet dokumentet shpesh të identifikimit, të parashikuara në pikën 9 të këtij neni, ai lejohet të votojë vetëm nëse paraqitet me certifikatë të re, letërnjoftim ose pasaportë.

11. Shtetasit shqiptarë që kanë emigruar jashtë vendit votojnë me pasaportë për jashtë shtetit, të vlefshme ose pasaportë, së cilës i ka skaduar afati ligjor i përdorimit, dhe Kartën e Identitetit të shtetit ku jeton. Evidentimi me një “E” në krah të emrit, në listat e zgjedhësve bëhet nga grupe të emëruara nga KQZ-ja dhe procedurat e përcaktuara nga ky organ. Grupet ngrihen jo më vonë se data 21 janar 2007 dhe veprojnë deri në datën 6 shkurt 2007.

12. Në zbatim të paragrafit “iv” të pikës 19 të këtij neni, procedura e pajisjes me certifikatë të re të atyre zgjedhësve që nuk kanë mundësi të mbledhin paketën e dokumenteve mbështetëse të identifikimit dhe që nuk zotërojnë asnjë dokument tjetër të lejueshëm për të vërtetuar identitetin e zgjedhësit, sipas Kodit Zgjedhor, bëhet si më poshtë:

a) zgjedhësit që janë pajisur me certifikata lindjeje me fotografi, të lëshuara para momentit të krijimit të Regjistrimit të Posaçëm të certifikatave në zyrën përkatëse të gjendjes civile, kanë të drejtë që:

i) në këmbim të këtyre certifikatave ata pajisen me përparësi në çdo kohë që paraqiten në zyrat e gjendjes civile me certifikatë lindjeje me fotografi, të lëshuar falas për efekte zgjedhore nga zyra e gjendjes civile ku është regjistruar në listën e zgjedhësve, certifikatë e cila regjistrohet detyrimisht në regjistrin përkatës;

ii) për zgjedhësit që nuk kanë mundur ta realizojnë më parë një të drejtë të tillë, 72 orë para ditës së zgjedhjeve dhe ditën e zgjedhjeve deri në orën 1400 realizohet dalja falas në fotografi, si dhe pajisja me certifikata falas të çdo zgjedhësi për efekt votimi. Kjo certifikatë regjistrohet detyrimisht në regjistrin përkatës;

b) gjatë gjithë kësaj periudhe shërbimi zyrat e gjendjes civile funksionojnë me orar të zgatur dhe për monitorimin e veprimtarisë së tyre në bashkitë në qendra qarqesh caktohen dy persona të emëruar nga prefekti (në çdo rast një person i propozuar nga partia e kundërt me spektrin politik që ka qeverisjen vendore në njësinë përkatëse).

13. Certifikatat e përdorura dhe fotokopje të dokumenteve shoqëruese të saj, të administruara gjatë procesit të votimit ruhen së bashku me materialin tjetër zgjedhor dhe me kërkesë të partive politike pjesëmarrëse në zgjedhje i vihen në dispozicion këtyre të fundit për verifikime të mëtejshme.

14. Partitë politike parlamentare kanë të drejtë të mbikëqyrin dhe të kontrollojnë veprimtarinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile. Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile ka detyrimin ligjor të vërë në dispozicion të partive politike listën elektronike të dublikatave të evidentuara me të gjitha të dhënat përkatëse.

15. Për këto zgjedhje, prodhimi, shpërndarja dhe përdorimi për zgjedhje i certifikatave të falsifikuara dënohet nga 2 deri në 5 vjet burgim. Kjo veprë e kryer në bashkëpunim dënohet me 3 deri në 7 vjet burgim.

16. Gjatë shqyrtimit administrativ të ankesave për pavlefshmëri, me kërkesën e argumentuar të të paktën dy anëtarëve, KQZ-ja është e detyruar të marrë në shqyrtim certifikatat e depozituara, regjistrat e tyre të depozituara në materialin zgjedhor dhe dokumentet mbështetëse.

17. Në çdo qendër votimi listës së zgjedhësve i shtohet numri serial i Regjistrimit Themeltar të Gjendjes Civile.

18. Këshilli i Ministrave, brenda 7 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, miraton aktet e nevojshme nënligjore për zbatimin e detyrave të përcaktuara në këtë nen.

19. KQZ-ja ngarkohet të realizojë një fushatë gjithëpërfshirëse informimi për t'i informuar zgjedhësit siç duhet:

i) se mjeti i preferuar për vërtetimin e identitetit të zgjedhësit në ditën e zgjedhjeve është pasaporta e vlefshme, nëse zgjedhësi e disponon një të tillë;

ii) rreth nevojës për të pasur gati dokumentet e përcaktuara mbështetëse të identifikimit në datën e zgjedhjeve, në qoftë se do të duan të përdorin certifikatat e vjetra të lindjes;

iii) se pa paketën e përcaktuar të dokumenteve mbështetëse të identifikimit që zgjedhësi duhet të paraqesë, votimi me certifikata të vjetra lindjeje nuk është i mundur;

iv) se ata zgjedhës me certifikatë të vjetër lindjeje, që nuk kanë mundësi të mbledhin paketën e dokumenteve mbështetëse të identifikimit dhe që nuk zotërojnë asnjë dokument tjetër të lejueshëm për të vërtetuar identitetin e zgjedhësit, sipas Kodit Zgjedhor, duhet t'i kërkojnë zyrës së gjendjes civile certifikatë të re, për qëllime zgjedhore, e cila duhet të lëshohet nga zyra e gjendjes civile pa pagesë;

v) se certifikatat e lindjes të përdorura për identifikimin e zgjedhësve në ditën e zgjedhjeve do të mblidhen të gjitha nga KQV-të (si dhe fotokopjet e dokumenteve mbështetëse të identifikimit).

20. KQZ-ja ngarkohet të nxjerrë aktet nënligjore në zbatimin e detyrave të përcaktuara në këtë nen.”.

Neni 40

Dispozitë kalimtare për afatet për përgatitjen e listave të zgjedhësve për zgjedhjet e para pas hyrjes në fuqi të këtij ligji

1. Sipas listës së marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, të përdorur për zgjedhjet e vitit 2005 brenda datës 21 janar 2007, zyrat e gjendjes civile, nën autoritetin e kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore dhe në zbatim të udhëzimeve të Ministrit të Brendshëm, mbështetur në regjistrat themeltarë me vendbanim të gjendjes civile, kryejnë përditësimin e listës si më poshtë:

a) evidentojnë dhe regjistrojnë të gjithë shtetasit që kanë mbushur moshën 18 vjeç pas datës së zgjedhjeve të fundit, duke përfshirë edhe ata që mbushin moshën 18 vjeç deri në datën e fundit për zhvillimin e zgjedhjeve;

b) evidentojnë dhe regjistrojnë në listën zgjedhore të njësisë së qeverisjes vendore zgjedhësit që janë regjistruar, shtuar në regjistrat themeltarë me vendbanim të gjendjes civile të kësaj njësie pas zgjedhjeve të fundit;

c) evidentojnë dhe çregjistrojnë zgjedhësit, që nuk figurojnë më në regjistrin themeltar me vendbanim të zyrave të gjendjes civile, për arsye se kanë vdekur ose kanë lënë shtetësinë shqiptare pas zgjedhjeve të fundit;

ç) evidentojnë dhe çregjistrojnë nga lista zgjedhore e njësisë së qeverisjes vendore, zgjedhësit të cilët janë në listë, por nuk ndodhen në regjistrin themeltar me vendbanim të kësaj njësie;

d) korrigjojnë problemet e evidentuara në listat e mëparshme, duke u bazuar në informacionin e marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe duke bërë kontrollin e tyre në regjistrat themeltarë me vendbanim.

2. Jo më vonë se data 21 janar 2007, kryetari i njësisë së qeverisjes vendore bën ndarjen e zgjedhësve sipas zonave të qendrave të votimit të zgjedhjeve të fundit dhe u cakton atyre numrin e qendrës përkatëse të votimit. Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore cakton vendndodhjen e saktë, adresën e plotë të qendrave të votimit, përgatit hartën e njësisë së qeverisjes vendore, në të cilën janë vendosur edhe kufijtë e zonave të qendrave të votimit dhe e shpall atë në mjedise publike, me hyrje të lirë, brenda njësisë së qeverisjes vendore. Kryetari i njësisë përkatëse mban të pandryshuar vendndodhjen dhe adresën ekzistuese të qendrës së votimit dhe, kur kjo është e pamundur, ndryshimi bëhet me miratim të KQZ-së. Ai nuk mund të ndryshojë vendndodhjen e qendrës së votimit në 25 ditët e fundit para datës së zgjedhjeve, përveçse në rastet e forcave madhore.

3. Listat paraprake shpallen nga kryetari i njësisë së qeverisjes vendore jo më vonë se data 21 janar 2007, pranë zyrave të njësisë përkatëse dhe çdo qendër votimi, duke i vendosur në mjedise publike me hyrje të lirë për shtetasit. Një kopje e këtyre listave u dërgohet zyrave të gjendjes civile përkatëse, të cilat përditësojnë në regjistrat themeltarë me vendbanim të gjendjes civile numrin e zonës së qendrës së votimit për çdo zgjedhës. Një kopje tjetër e këtyre listave i dërgohet menjëherë në format elektronik Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile.

4. Kërkesat për ndryshime në listën paraprake të zgjedhësve nga zgjedhësi mund t'i paraqiten kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore, jo më vonë se data 6 shkurt 2007.

5. Jo më vonë se data 6 shkurt 2007, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile u kërkon kryetarëve të njësive të qeverisjes vendore, në regjistrin themeltar të të cilëve zgjedhësi ka regjistrime të mëparshme, ta heqë atë nga lista e zgjedhësve, për shkak të ndodhjes në më shumë se një listë zgjedhësish.

6. Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore vendos për kërkesën e bërë nga zgjedhësi brenda 24 orëve nga depozitimi i saj. Një kopje e vendimit i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile në përfundim të periudhës së rishikimit dhe një kopje mbahet nga kryetari i njësisë së qeverisjes vendore. Në rast se kërkesa refuzohet, kryetari i njësisë së qeverisjes vendore i dërgon një kopje kërkesës, jo më vonë se 24 orë nga data e marrjes së vendimit.

7. Kundër vendimit të kryetarit të bashkisë, komunës ose njësisë bashkiake ose në rastin kur ai nuk merr vendim, mund të bëhet ankim nga kërkesuesi në gjykatën e rrethit gjyqësor, ku ndodhet njësia e qeverisjes vendore, jo më vonë se 48 orë nga marrja dijani për vendimin ose nga kalimi i afatit për marrjen e vendimit.

8. Gjykata shqyrton çështjen dhe merr vendim brenda 24 orëve nga çasti i paraqitjes së kërkesëpadiisë. Në rast se paditësi ose përfaqësuesi i tij ligjor nuk paraqitet në gjykim, gjykata pushon gjykimin. Në rast se i padituri nuk paraqitet në gjykim, gjykimi zhvillohet në mungesë. Gjykata duhet t'i njoftojë vendimin palës në mungesë, sipas dispozitave përkatëse të Kodit të Procedurës Civile, brenda 24 orëve nga data e shpalljes së vendimit. Kryetari i njësisë përkatëse të qeverisjes vendore është i detyruar të zbatojë vendimin e gjykatës, brenda 24 orëve nga marrja dijani, pa qenë nevoja që paditësi të kërkojë lëshimin e urdhrin të ekzekutimit. Në çdo rast, gjykata vë në dispozicion të palëve vendimin e saj të arsyetuar me shkrim, në të njëjtën datë me shpalljen e vendimit. Në rast se gjykata merr vendim pas afatit për miratimin e listave përfundimtare, sipas kësaj pike, zgjedhësi voton sipas procedurës së përcaktuar në nenin 60 pika 3 të këtij Kodi.

9. Pas miratimit nga kryetari i njësisë së qeverisjes vendore, listat përfundimtare të zgjedhësve i dërgohen KZQV-së jo më vonë se data 7 shkurt 2007, të printuara në tre formate, sipas përcaktimeve të nenit 59 të Kodit. Listat përfundimtare i dërgohen Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile edhe në format elektronik. Formatit të listës përfundimtare, të përgatitur sipas nenit 59 pika 2 shkronja "b", i shtohen edhe të dhënat e pikave 11 dhe 17 të nenit 39 të këtij ligji.

10. Brenda 24 orëve nga marrja e listave përfundimtare, KZQV-ja i shpall ato pranë qendrave përkatëse të votimit në një vend me hyrje të lirë.

11. Brenda 10 ditëve nga miratimi i listave paraprake dhe atyre përfundimtare të zgjedhësve, në përputhje me procedurat e nenit 56 të këtij Kodi, kryetari i njësisë së qeverisjes vendore njofton me shkrim zgjedhësit për numrin dhe vendndodhjen e qendrës së votimit.

12. Për procedurat dhe afatet që nuk janë përcaktuar ndryshe nga ky nen, zbatohen dispozitat e tjera të Pjesës së Katërt të këtij Kodi.

Neni 41

1. Në nenet 55, 58, 59, 64, 64/1 dhe 94 fjalët "Ministër i Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit" bëhen "Ministri që mbulon pushtetin vendor", kurse fjalët "Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit" bëhen "Ministria që mbulon pushtetin vendor".

2. Në nenin 116 fjalët "Ministri i Rendit Publik" bëhen "Ministri që mbulon rendin publik".

3. Fjala "regjistër themeltar" bëhet "regjistër themeltar me vendbanim".

Neni 42

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.5192, datë 14.1.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

L I G J
Nr. 9677, datë 13.1.2007

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8410, DATË 30.9.1998 "PËR
RADION DHE TELEVISIONIN PUBLIK E PRIVAT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË",
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin 8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Neni 8 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 8
Përbërja

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit përbëhet nga Kryetari, Zëvendëskryetari dhe 5 anëtarë të zgjedhur nga radhët e personaliteteve në fushat e politologjisë, drejtësisë, masmedias, sociologjisë apo shkencave të tjera humanitare, të cilat kanë lidhje ose ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë mbi qëllimet e veprimtarisë radiotelevizive, siç përcaktohet në nenet 35 e 36 të këtij ligji.

KKRT-ja ushtron veprimtarinë e vet në përputhje me këtë ligj nën mbikëqyrjen e Kuvendit.

Funksioni i Kryetarit dhe i Zëvendëskryetarit është me kohë të plotë dhe i papajtuësëm me çdo detyrë ose funksion tjetër publik e privat, me përjashtim të mësimdhënies.

Paga e Kryetarit, e Zëvendëskryetarit dhe masa e shpërblimit të 5 anëtarëve të tjerë të këtij këshilli caktohet në përputhje me ligjin nr.9584, datë 17.7.2006 "Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të pavaruara të krijuara me ligj. ".

Neni 2

Në nenin 9 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"1. Anëtarët e Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit zgjidhen nga Kuvendi për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë. Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik i propozon Kuvendit 2 kandidatura alternative për çdo vend anëtarë të KKRT-së, pas një përzgjedhjeje mes të paktën 4 kandidaturave të propozura nga subjektet përkatëse si më poshtë:

- a) nga shoqatat dhe grupimet e mediave elektronike;
- b) nga shoqatat e medias së shkruar;
- c) nga profesorati dhe shoqatat e inxhinierisë elektrike dhe elektronike;
- ç) nga profesorati i së drejtës, shoqatat e juristëve dhe Dhoma Kombëtare e Avokatisë;
- d) nga subjektet parlamentare;

dh) nga organizatat jofitimprurëse që veprojnë në fushën e të drejtave të njeriut, të drejtave të fëmijëve ose kërkimeve në politikat publike.”.

2. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Për përzgjedhjen e kandidatave alternative për çdo vend anëtar të KKRT-së, Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik zbaton procedurën e mëposhtme:

Kandidaturat e administruara, në bazë të propozimeve të mësipërme, i nënshtrohen përjashtimit një nga një deri në mbetjen e një numri që i korrespondon dy të tillave për çdo vend anëtar, të cilat i propozohen seancës plenare. Procedura e përjashtimit zbatohet sipas radhës: një nga përfaqësuesit e shumicës parlamentare dhe një nga përfaqësuesit e opozitës.

3. Në fjalinë e dytë të paragrafit të dytë të pikës 5 numri “3” zëvendësohet me numrin “5”.

Neni 3

Neni 17 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 17

Kuorumi dhe vendimmarrja

1. Mbledhjet e KKRT-së janë të vlefshme kur në to marrin pjesë jo më pak se 4 anëtarë, me përjashtim të rasteve kur kërkohet shumicë e cilësuar për marrjen e vendimit sipas pikës 2 të këtij neni.

2. Vendimet e KKRT-së, të marra sipas pikave 5 dhe 6 të nenit 7 dhe pikës 5 të nenit 9 të këtij ligji, quhen të miratuara kur për to votojnë pro jo më pak se 5.”.

Neni 4

Në nenin 88 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Këshilli Drejtues i RTSH-së përbëhet nga 11 anëtarë, të cilët zgjidhen nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë pas një përzgjedhjeje në bazë të propozimeve të subjekteve përkatëse të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni.”.

2. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik i propozon Kuvendit 2 kandidatura alternative për çdo vend anëtar të Këshillit Drejtues të RTSH-së, pas një përzgjedhjeje mes të paktën 4 kandidatave të propozuara nga subjektet përkatëse si më poshtë:

a) nga shoqatat e grupimet e mediave elektronike dhe shoqatat e medias së shkruar;

b) nga senatet e universiteteve publike;

c) nga profesorati dhe shoqatat e inxhinierisë elektrike dhe elektronike;

ç) nga shoqatat e juristëve dhe Dhoma Kombëtare e Avokatisë;

d) nga organizatat jofitimprurëse që veprojnë në fushën e të drejtave të njeriut, të drejtave të fëmijëve ose kërkimeve në politikat publike;

dh) nga Qendra Kombëtare e Kinematografisë, institucionet publike të artit skenik dhe shoqatat e shkrimtarëve.”.

3. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Për përzgjedhjen e kandidatave alternative për çdo vend anëtar të Këshillit Drejtues të RTSH-së, Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik zbaton procedurën e mëposhtme:

Kandidaturat e administruara, në bazë të propozimeve të mësipërme, i nënshtrohen përjashtimit një nga një deri në mbetjen e një numri që i korrespondon dy të tillave për çdo vend anëtar, të cilat i propozohen seancës plenare. Procedura e përjashtimit zbatohet sipas radhës: një nga përfaqësuesit e shumicës parlamentare dhe një nga përfaqësuesit e opozitës.”.

4. Në pikën 6 fjalët “3 anëtarë” zëvendësohen me fjalët “5 anëtarë”.

Neni 5

Neni 95 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 95

1. Mbledhjet e Këshillit Drejtues të RTSH-së janë të vlefshme kur në to marrin pjesë shumica e anëtarëve. Vendimet e Këshillit Drejtues të RTSH-së merren me shumicën e votave të pjesëmarrësve, me përjashtim të rasteve, kur kërkohet shumicë e cilësuar për marrjen e vendimit, sipas pikës 2 të këtij neni.

2. Vendimet e Këshillit Drejtues të RTSH-së, të marra sipas pikave 1 dhe 3 të nenit 99 të këtij ligji, quhen të miratuara, kur për to votojnë pro jo më pak se 7 anëtarë.”.

Neni 6

Dispozitë kalimtare

Kuvendi brenda, 10 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, zgjedh anëtarët e rinj të KKRT-së dhe të Këshillit Drejtues të RTSH-së sipas këtij ligji.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.5193, datë 14.1.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

DEKRET

Nr. 5188, datë 13.1.2007

PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR HYRJEN NË FUQI MENJËHERË TË LIGJIT

Në mbështetje të neneve 84, pika 4 dhe 93 të Kushtetutës bazuar në kërkesën e Kuvendit

DEKRETOJ:

Neni 1

Jepet pëlqimi për hyrjen në fuqi menjëherë të ligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë””;

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

DEKRET
Nr. 5189, datë 13.1.2007

PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR HYRJEN NË FUQI MENJËHERË TË LIGJIT

Në mbështetje të neneve 84, pika 4 dhe 93 të Kushtetutës bazuar në kërkesën e Kuvendit

DEKRETOJ:

Neni 1

Jepet pëlqimi për hyrjen në fuqi menjëherë të ligjit “Për disa ndryshime në ligjin nr.9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

DEKRET
Nr. 5190, datë 13.1.2007

PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR HYRJEN NË FUQI MENJËHERË TË LIGJIT

Në mbështetje të neneve 84, pika 4 dhe 93 të Kushtetutës bazuar në kërkesën e Kuvendit

DEKRETOJ:

Neni 1

Jepet pëlqimi për hyrjen në fuqi menjëherë të ligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

DEKRET
Nr. 5194, datë 14.1.2007

**PËR SHFUQIZIMIN E DEKRETIT NR.5131, DATË 2.12.2006 “PËR CAKTIMIN E DATËS
SË ZGJEDHJEVE PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE” DHE CAKTIMIN E
DATËS SË ZGJEDHJEVE PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE**

Në bazë të neneve 92 germa “gj” dhe 93 të Kushtetutës, si dhe të nenit 181/1 të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dekreti nr.5131, datë 2.12.2006 “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore”, shfuqizohet.

Neni 2

Zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të zhvillohen ditën e diel, datë 18 shkurt 2007.

Neni 3

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi Zhan d'Ark, prapa ish-Ekspozitës "Shqipëria Sot", Tel: 042 555 63; ose 04 267 468
Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2007 është 16 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

- 1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
- 2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
- 3. REGJISTRAT E NOTERISË**
- 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:**
 - 1. PËR PROKURIMIN PUBLIK (2006) 1500**
 - 2. PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005) 600**
 - 3. PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë dhe vëllimi i II-të-2006)..... 1500**
 - 4. PËR TAKSAT DHE TATIMET (+suplement 2006)..... 1500**

- 1. TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT..... 1500**
- 2. TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT..... 2000**

BOTIME TË REJA

- 1. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT..... 500**
- 2. KODI DOGANOR..... 1000**
- 3. KODI DETAR..... 1000**

Hyri në shtyp më 14.1.2007
Doli nga shtypi më 14.1.2007

Tirazhi: 3500 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja Grafon
Tiranë, 2007

Çmimi: 24 lekë